



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 22
Prishtinë, më 14 shtator 2011, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCIVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Afrim Hoti, Adem Grabovci, Bali Muharremaj dhe Albert Kinolli.

Deputet të tjerë pjesëmarrës: Alma Lama

Mungoi: Bali Muharremaj dhe Afrim Hoti.

Të ftuar: Lars Lage OLOFSSON –auditor i përgjithshëm, Gani Gërguri-BQK, Enver Hasani-Gjykata Kushtetuese.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri- koordinatorë, KIPRED (staf mbështetës) Artan Venhari dhe Albert Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Shqyrtimi i Raportit vjetor me pasqyrat e audituara financiare të Bankës Qëndrore të Kosovës, për vitin 2010,
3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për vitin 2010.
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi Rendin e ditës pa ndryshime.

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor me pasqyrat e audituara financiare të Bankës Qendrore të Kosovës, për vitin 2010

Kryetari – Pyeti: Sa është procesi i pavarësisë institucionale dhe financiare të BQK-jë. BQK ende nuk po kryen funksionin e plotë të saj: mungesa e tregut financiar, mungesa e tregut të kapitaleve dhe emitimi i parasë e ne veçanti emitimi i parasë ku Kosova humb vlerën e rikrijuar. Kërkoj sqarim lidhur me këtë.

Kontrolli i sistemit bankar- çfarë mekanizma keni krijuar qoftë në krijimin e stafeve të tyre dhe politikave operuese të tyre.

Rasti i krizës financiare në bote- shtypi manipuloi shumë se po tërhiqen depozitat prej Raiffeisen Bankë. Cili është proporcioni i depozitave me plasim? ProCredit thuhet se nuk është bankë, ndërsa flitet se është një fond investiv. Kërkoj sqarim lidhur me këtë.

Valbona Dibra - Përgëzoi BQK për një raport të detajuar. Pyeti: çka është duke ndërmarrë BQK-ja në uljen e interesit gjatë dhënies së kredive, kur bankat komerciale po përfitojnë shuma marramendëse.

Adem Grabovci – Përgëzoi BQK-në për punën dhe suksesin e deritanishëm. Pyeti: a ka të dhëna BQK-ja për mjetet e grumbulluara nga sigurimet e automjeteve në zonat kufitare dhe për çka shfrytëzohen ato?

Mursel Halilji – Rreziku se disa banka në Kosovë dëshirojnë të marrin mjetet dhe të shkojnë nga Kosova ekziston. Pyeti: a ka BQK-ja mekanizma për mbrojtje nga këto rrethana? Është evidente se mund të vije deri te kriza. Që të gjitha institucionet bankare në një moment mund të tërheqin mjetet e tyre. A mund të merret me këtë problem BQK-ja dhe a ka mekanizëm për parandalimin e një dukurie të tillë?

Alma Lama – Konkurrenca që po zhvillohet e duket që nuk është e ndershme si në mes bankave ashtu edhe në mes të kompanive të sigurimeve. Pyeti: si i menaxhon BQK këto çështje?

Ramiz Lladrovci –Tha se për herë të parë është bërë zgjedhja e guvernatorit me konkurs dhe i njëjti ka përvorjen e duhur. Sistemi bankar i qëndrueshëm është shtytësi kryesor i rritjes ekonomike të paraparë në politikat e Kosovës. Ai konsideron se BQK-ja do të vazhdojë të punojë me një dinamizëm edhe më të shtuar në analizimin, gjetjen dhe aplikimin e masave për përmirësimin e mëtutjeshëm të ambientit për bizneset, jo vetëm për të nxitur investitorët nga jashtë, por për të nxitur edhe investitorët e brendshëm. Dha vlerësimin më të lartë për punën e BQK-së për vitin 2010, e cila ka realizuar planin e planifikuar, dhe ka realizuar agjendën e bankës, duke pasur parasysh problemet e krijuara në këtë vit. Gjatë krizës së vitit 2010 BQK-ja ka arritur të menaxhojë mjetet me efikasitet dhe me një fitim i cili ka qenë pozitiv. Përgëzoi BQK për raportin gjithëpërfshirës të cilin Komisioni do t'ja procedojë Kuvendit për miratim.

Albert Kinolli – Pyeti: Në çfarë gjendje ka gjetur BQK-në guvernatori aktual dhe me cilat sfida po ballafaqohet BQK-ja? Sa keni arritur që për këtë BQK të tejkaloi këto sfida si dhe sa është i kënaqur guvernatori me profesionalizimin e stafit?

Gani Gërguri –BQK- Lidhur me pavarësinë e BQK-së tha se ligji aktual është me standardet më moderne të bankut dhe si i tillë ka ofruar pavarësinë e BQK-së. Kosova është në vendet e rralla, ku guvernatori i një shteti zgjidhet përmes një gare konkurruese të një konkursi publik. Pavarësia e BQK është e garantuar me ligj dhe me formën e vendimmarrjes në tri shtylla: Bordi i Bankës – i cili përbehet nga 5 anëtarë jo ekzekutiv dhe një është guvernatori që ullet në bord dhe përbehet kuorumin. Me ligjin e ri bordi ka më tepër një funksion të monitorimit të ekzekutivit që përbehet shtyllën e dytë-bordin që përbehet nga guvernatori dhe zv.guvernatorë. Numri i

zv.guvernatorëve nuk është i kufizuar, kjo varësisht se si bordi i epërm e sheh të arsyeshme që kërkon për të realizuar agjendën e BQK-së. Guvernatori me ligj ka disa kompetenca dhe detyra specifike për të cilat mund të vendos vet. Sistemi tre shtyllës gjendet në shumë pak Banka Qendrore në rajon dhe kjo siguron pavarësinë institucionale të BQK-së.

Pavarësia financiare - edhe në këtë drejtim ligji ka qenë në favor të pavarësisë së bankës. Banka ka kapitalin e vet prej 30 milion euro. Kjo është një siguri financiare, pastaj Banka ka mundësi të menaxhoj asetet e saj- domethënë parat që depozitohen në bankë. Sipas ligjit, banka mund të investoj këto mjete në bazë të të cilit të siguroj të hyrat, për të mbuluar koston e operacioneve të saja.

Parat e AKP janë diku 600milion, bilancet bankare - Qeveria janë 200milion deri 300milion varësisht se si është marrëveshja me FMN. Rezervat e obliguara të cilat bankat komerciale duhet të mbajnë me BQK-në janë afër 200, diçka pastaj nga kompanitë e sigurimeve dhe e gjithë kjo përbënë portfolion e BQK-së që është rreth 1miliard e 100milion apo 200milion, varësisht prej bilanceve që ka Qeveria me BQK-në. Këto mjete plasohen jashtë dhe mënyra se si plasohen këto mjete jashtë është e bazuar në politikën e investimeve të mjeteve të BQK-së, e cila është e aprovuar nga Bordi, ku janë të specifikuar tri kritere bazike: siguria, likuiditeti dhe kthimi nga ato mjete.

Emetim i parasë - për këtë duhet të vendos Kuvendi. BQK është e përgatitur për të kryer emetimin e parasë, por ky projekt është nacional - shtetërorë dhe është vendim politik. Këtu hyjnë edhe tregu financiar (në Kosovë treg financiar ka vetëm në sistemin bankar) dhe tregu i kapitalit. BQK – qëndron mirë lidhur me këtë falë Ligjit për Borxh Publik dhe është e gatshme-kompletimi i infrastrukturës do të jetë i gatshëm në nëntor. Pas implementimin të tregut të letrave me lere BQK në fund të nëntorit do të ketë një këshilltarë nga Thesari Amerikan i cili do të punoj një vit në BQK, për përgatitjen e studimit të fizibilitetit për avancimin e mëtejme të tregut të kapitalit, me një objektiv që në fund nëse arrihet marrëveshje me shtetet fqinje që të krijohet një bursë e përbashkët regjionale në të cilën pastaj do të listohen kompanitë më të suksesshme. BQK nuk është tamam Bankë Qendrore për shkak të aranzhmanit të eurozimit i cili është unilateral. BQK si rrjedhojë është fokusuar më shumë në përgjegjësitë që kanë të bëjnë me licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e të gjitha institucioneve financiare. BQK ka siguruar një sektor financiar shumë stabil e sidomos një sektor bankar të qëndrueshëm.

Mekanizmat e kontrolli janë zhvilluar kryesisht me asistencën e USAID-it, ato tani do të rishikohen, sepse BQK është duke përgatitur Ligjin e ri për bankat komerciale, për mikrofinancat dhe për institucionet financiare jobankare, i cili me FMN dhe MF parashihet të miratohet në Kuvend në nëntor. Pra mekanizmat e kontrollit ekzistojnë, akterët janë me pronësi private shumica prej të cilëve janë me kapital të huaj.

Plasmanëve nga jashtë – sistemi bankar është stabil edhe për shkak të faktit se mbledh depozitat të cilat i përkthen në kredi në ekonomi familjare, individ dhe ndërmarrje të mesme dhe të vogla. Sistemi bankar në Kosovë funksionon me një formulë shumë të thjeshtë e cila e mbron për mos me qenë i ekspozuar ndaj zhvillimeve të jashtme në tregun global. Në këtë kontekst kemi kufizime sa i përket plasmanëve nga jashtë. Është rregull e shkruar që asnjë bankë nuk mund më shumë se 20% të ekspozohet me bankat e tjera brenda grupit të cilit i përket.

ProCredit në Kosovë është bankë, por nuk është bankë në Gjermani. BQK ka kërkuar nga Pro Credit që të marrë licencë nga rregullatori i tij në Gjermani, sepse atje janë të organizuar si Holding.

Ligji i BQK-së nuk parasheh normën e interesit, sepse BQK nuk emeton para. Norma e interesit është shumë e lartë, mirëpo këto vije si rezultat i arsyeve që bankat komerciale i sjellin në BQK. BQK është pjesë aktive e projektit të avancimit të ambientit për biznes në Kosovë projekt ky i USAID i cili adreson këto arsyetime të bankave.

BQK garanton stabilitetin financiar - Komisioni i Konkurrencës ka katër objektiva e që kanë të bëjnë me atë që të hetohen marrëveshjet e ndaluara në treg. Në këtë kontekst për të eliminuar çfarëdo konfuzioni dhe keqpërdorimi. BQK ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Komisionin e Konkurrencës, sipas së cilës BQK ofron çdo informacion që ndihmon Komisionin e Konkurrencës në kryerjen e misionit, për çka edhe janë të mandatuar nga Kuvendi. Ata janë në fazën e hulumtimit si të bankave ashtu edhe të Kompanive të Sigurimeve.

Sigurimet kufitare- janë vendosur për të gjithë të huajt që hyjnë në Kosovë pavarësisht nëse është fjala për bashkatdhetarët apo për të huajt. Kartoni i Gjellbër nuk vlen në Kosovë, sepse nuk njihen dëmet që mund të ndodhin në Kosovë. BQK nuk ka bërë mjaft për anëtarësim në Kartonin e Gjellbër, por tani është shtyrë miratimi i Ligjit për autopërgjegjësi si parakusht i parë për Anëtarësim në Kartonin e Gjellbër. Me këtë ligj është themeluar Byroja Motorike e Kosovës i cili është i vetmi institucion që ka të drejtë të aplikoj në Këshillin e Kartonit të Gjellbër për anëtarësim.

BQK ka 170 punëtorë. Momentalisht janë 6 kandidatë për doktoratur në Britani të Madhe, 31 me magjistraturë.

Sfidat e BQK-së- BQK ka pasur sfidë e sidomos gjatë viti 2010 për ruajtjen e stabilitetit financiar. BQK ka treguar që është një institucion shuam i pjekur, ka një strukturë menaxhuese. Janë refuzuar disa kërkesa për licenca bankare, sigurime, kritika e opinionit lidhur me mjetet e privatizimit e që është sqaruar se janë krijuar me ligje të veçanta e jo me Ligjin e BQK-së.

Nexhat Kryeziu – BQK - Mandati i BQK te mbikëqyrja e Kompanive të Sigurimit është mbrojtja e interesave të palës së dëmtuar dhe të polis-mbajtësve. BQK është e interesuar që në momentin që një qytetar, që dikush tjetër-pala e tretë i shkakton aksident, ai merr kompensimin e merituar në bazë të dëmit të shkaktuar. BQK është e interesuar të gjejë balancë në mes të tarifave duke krahasuar rajonin, shkallën ekonomike që mund të paguajnë qytetarët e Kosovës.

Kryetari – Banka Qendrore ende nuk ka arritur të kryej disa funksione që janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e Kosovës. Banka ka stafin profesional për të marrë edhe ato përgjegjësi duke përfshirë këtu edhe emetimin e parasë, pasi që vlera e re e rikrijuar nuk mbetet në Kosovë, si dhe në sfera të tjera e sidomos në tregun financiar.

Propozoi që Komisioni t'i rekomandoj Kuvendit që të shikoj të gjitha mundësitë që Banka Qendrore të marrë funksionin e plotë të saj. Nëse është nevoja edhe ligji mund të ndryshohet.

Ramiz Lladrovci – Komisioni të përkrah raportin e BQK dhe rekomandohet Kuvendit që t'i plotësoj kushtet në mbulimin e sferave që kërkohen nga ajo.

Kryesuesi konstatoi se të pranishëm në mbledhjen e Komisionit ishin gjashtë deputet. Me gjashtë vota “për” dhe asnjë “kundër”, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike ka vendosur që Kuvendit t'i

REKOMANDOJ

- 1. Të miratohet Raporti vjetor me pasqyrat e audituara financiare të Bankës Qendrore të Kosovës, për vitin 2010**
- 2. Kuvendi i Republikës së Kosovës, të shikoj të gjitha mundësitë për t'i plotësuar kushtet Bankës Qendrore të Kosovës, që të kryej funksionin e saj të plotë për detyrat e parapara.**
- 3. Arsyetimin e Rekomandimit e paraqet, deputeti Ali Sadriu, kryetar i Komisionit.**

3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për vitin 2010

Kryesuesi konstatoi se, për shkak të mospjesëmarrjes në mbledhjen e Komisionit të kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri nxori këtë

PËRFUNDIM

Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për vitin 2010, shtyhet për një mbledhje tjetër të Komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20.

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu